



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 147 prot.

Kamëz, më 21.12.2022

V E N D I M
Nr. 167 Datë 21/12/2022

PËR
PËR MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TE PUNONJESVE TE QENDRES
MULTIFUNKSIONALETE TE BASHKISE KAMEZ PER VITIN 2023.

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.21.12.2022, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.147 dt 19.12.2022,

Ne mbështetje te nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, shkronja b neni 54 shkronja ç dhe nenin 55 pika 2 te ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendor" neni 113 te ligjit 44/2015 date 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës se Shqiperise" (i ndryshuar) neni 2 shkronja "c" dhe nenit 5 shkrona "a" te ligjit nr.10405 date 24.03.2011 "Per kompetencat e caktimit te pagave dhe te shperblimeve" pika 17 te vendimit nr.165 date 02.03.2016 te Keshillit te Ministrave "Per grupimin e njesive te vetqeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar te nepunesve civile dhe te punonjesve administrative te njesive te vetqeverisjes vendore (i ndryshuar) i ndryshuar me VKM-në nr.177, datë 08.03.2017, dhe VKM-në nr. 625, datë 28.09.2022 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të nepunesve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vete qeverisjes vendore", sipas Lidhjes III bashkëlidhur në VKM nr. 717 date 23,06,2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Miratimin e nivelit të pagave për punonjeset e cerdheve sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.01.2023.
3. Pagat e punonjësve administrative, të jenë në masën 41,700 (dyzete njemije e shtateqind) lekë në muaj sipas pikës 19, të VKM-së te sipercituar.

Niveli i pagave per punonjesit e Cerdheve bashkia Kamez

Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa per vjetersi	Shtesa per pozicion	Arsimi
Pergjegjes qendre	IV-A	1/2/3	2%	59,000	I Larte
Specialist qendre (fizioterapist, logopet, infermier, psikolog, punonjes social,	IV-B	1/2/3	1% ose 2%	52,000	I Larte/i mesem

Grupi Diplomes	Lloji i Diplomes	Vlera
1	Master i shkencave, master i arteve Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	14000
2	Master profesional Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	11000
3	Bachelor Te barasvlershme me to sipas legjislacionit te arsimit te larte	10000

1. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR

HYSEN KOLDASHI